

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE  
INFRASTRUKTURES**

**NJOFTIM FITUESI**

**PËR DHËNIEN ME KONCENSION TË "NDËRTIMIT TË LANDFILLIT PËR TRAJTIMIN E  
MBETJEVE TË QARKUT DURRËS"**

Drejtuar: Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "Kinexia" dhe "Albanian Landfill Energy"

**Adresa:** Rruga "Myrteza Topi", ndërtesa nr.18, hyrja nr.7, ap.38

**Nr. i referencës së koncesionit:** REF-55182-09-17-2014

Autoritetet Kontraktuese Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit dhe Infrastruktues lajmërojnë Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "Kinexia" dhe "Albanian Landfill Energy", se oferta e paraqitur më datë 18.11.2014, për marrjen me koncesion të "Ndërtimit të landfillit për trajtimin e mbetjeve të qarkut Durrës" për vlerën totale të investimit 2,861,640,570 leke (dy miliard e teteqind e gjashtedhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzetmijë e peseqind e shtatedhjetë leke) është pranuar.

Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Transportit dhe Infrastruktues fton bashkimin e përkohshëm të shoqërive "Kinexia" dhe "Albanian Landfill Energy" për fillimin e negociemeve të kontratës, e cila duhet të nënshkruhet brenda 30 ditëve.

Ofertuesi, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "Kinexia" dhe "Albanian Landfill Energy" duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Mjedisit, adresa Rruga e Durrësit Nr.27 – Tiranë", dokumentete mëposhtme:

- Afati i negociimit të Kontratës tuaj do të jetë në përputhje me afatet e parashtruara në VKM Nr. 27, datë 19.01.2007 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve", i ndryshuar dhe Ligjin 9663 dt 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar.
- Kopjen e vënies në dijëni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Aneksin VII-4 të Dokumentave Standarte të Procedurës Konkursuese. Sigurimi duhet të paraqitet jo më vonë se në momentin e nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Dokument bankar që vërteton pagesën e kryer për shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulencës së specializuar (në rast se ka). Kjo pagesë do të kryhet para fillimit të negociatave.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

Këto detyrime duhet të plotësohen përpara negociimit të kontratës.